



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1350/1 Prot.

Tiranë, më 02 / 10 / 2018

**V E N D I M**

**Nr. 194 , Datë 02 / 10 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 102, datë 11.07.2018, të paraqitur nga M.M kundër Zyrës Arsimore Devoll në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak “bindjes politike<sup>1</sup>”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në portalin “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2017 është renditur në vend të tretë në profilin e lëndës Gjuhë Shqipe-Letërsi. I është drejtuar disa herë ZA Devoll për tu punësuar si mësuese në shkollat: “Banush Tarelli” Braçanaj, “Dritëro Agolli” dhe “Fuat Babani” Bilisht por që nuk ka arritur të punësohet pasi nga ZA Devoll nuk zbatohen procedurat e punësimit të mësuesve sipas Udhëzimit nr.38, datë 06.10.2015 të MASR”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe punësimin e saj pavarësisht bindjes politike.

**II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>1</sup> MM është anëtare e subjektit politik “Partia Demokratike”, referuar kartës së anëtarësisë datë 14.05.2014.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën me nr.991/1 prot., datë 13.07.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, ZA Devoll, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga M.M.

Me shkresën nr.565, datë 24.07.2018, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyra Arsimore Devoll, në mes të tjerash ka informuar se: “Në portalin e vitit 2016-2017, MM është renditur e treta në profilin Gjuhë-Letërsi. Në këtë profil rezultojnë të punësuar vetëm dy vendet e para (vendi i dytë me kontratë, zëvendëson mësuese me leje lindje)”.

2. Me shkresën nr. 991/3, datë 10.09.2018 i është kërkuar informacion subjektit Zyra Arsimore Devoll në lidhje me: - Procedurën e emërimit me kontrata të përkohshme, jashtë profili për mësueset: O.A, Xh.P dhe J.B.

Me shkresën nr.830, datë 19.09.2018, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyra Arsimore Devoll, në mes të tjerash ka informuar se: “Mësuesja O.A për vitin shkollor 2017-2018 është punësuar mësuese me kontratë të përkohshme në shkollën 9-vjeçare “Banush Tarelli” Braçanj. Mësuesja Xh.P për vitin shkollor 2017-2018 është punësuar mësuese me kontratë të përkohshme në shkollën 9-vjeçare “Fuat Babani” Bilisht dhe znj. J.B nuk është punësuar asnjëherë si mësuese pranë ZA Devoll”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankueses nga ZA Devoll.

Ankuesja, M.M në portalin “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2016-2017, ka qenë e renditur në vend të tretë në profilin, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi. Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se në vitin shkollor 2017-2018, Komisioni i Vlerësimit të ZA Devoll ka rekomanduar mësuesit: P.P dhe L.P të renditur në vendin e parë dhe të dytë të portalit, për tu punësuar si mësues në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, në shkollat 9-vjeçare: “Xhevair Gjyli” Menkulas dhe “Fuat Babani” Baban.

Me shkresën nr.27, datë 12.01.2018, ZA Devoll ka informuar ankuesen se emërimi i mësueses O.A, në shkollën 9-vjeçare Braçanj me kontratë me kohë të pjesshme, si mësuese jashtë plogfili në lëndën Edukim Fizik është bërë nga drejtoria e kësaj shkolle. Gjithashtu, dhe në përgjigjen drejtuar ankueses në datë 22.02.2018 nga Zyra e Bashkëqeverisjes<sup>3</sup> informohet se: Mësueset O.A dhe Xh.P punojnë me kontratë në profilin Edukim Fizik, përkatësisht në shkollën 9-vjeçare “Banush Tarelli” Braçanj dhe në gjimnazin “Fuat Babani” Bilisht.

Në nenin 57/4 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: *“Mësuesi i arsimit fillor dhe i arsimit të mesëm ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit pasi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale dhe të ketë kaluar provimin e shtetit, siç parashikohet në ligjin nr.10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në RSH” të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij”.*

Në Kreun 1, pika 4 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit marrin pjesë në konkurim, i cili zhvillohet në tri faza: A. Konkurrim me dosje. B. Konkurrim nëpërmjet testimit “Mësues për Shqipërinë”. C. Zgjedhja e vendit të punës”.* Ndërsa në Kreun 4, pika 2 “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit” të këtij udhëzimi përcaktohet se: *“2. “Kandidati me numrin më të madh të pikëve ftohet nga komisioni dhe zgjedh një nga vendet e lira të punës (me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme), sipas preferencës së tij, në prani të drejtorëve të institucioneve arsimore ku janë vendet e lira të punës”.*

**Referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara, arrihet në përfundimin se për tu punësuar si mësues me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme në institucionet e arsimit parauniversitar duhet të respektohen procedurat e caktuara në Udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, procedurë e cila është respektuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ZA Devoll, për emërimet e kryera për vendet vakante në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në rastin e emërimit të mësuesve, P.P dhe L.P të renditur në vendin e parë dhe të dytë të portalit 2016-2017.**

<sup>3</sup> [zyraebashkeqeverisjes@shqiperiaqeduam.al](mailto:zyraebashkeqeverisjes@shqiperiaqeduam.al), përgjigje kërkesës Nr. 8601.

Referuar Udhëzimit nr. 44, datë 16.10.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar” përcaktohet se: *“Për arsimin e mesëm të ulët (klasat VI-IX) profili i kërkuar për mësuesit në lëndën, Edukim Fizik është: Edukim Fizik ndërsa profili i përafërt është: E mesme e fizkulturës e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit”.*

Referuar renditjes së portalit “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2016-2017, konstatohet se mësueset: MM është e renditur në vend të 3 me 62 pikë në lëndën Gjuhë Shqipe Letërsi (GJSHL), O.A është e renditur në vend të 12 me 52 pikë në lëndën Gjuhë Shqipe Letërsi (GJSHL), ndërsa mësuesja Xh.P është e renditur në vendin e 9 me 29 pikë në lëndën Shkenca Sociale (SHS).

Referuar arsimimit të mësueseve M.M, O.A dhe Xh.P dhe kriterëve të kërkuara nga legjislacioni në fuqi, vërtetohet se asnjë nga mësueset e sipërcituara nuk plotësojnë kriterin e profilit të kërkuar si mësuese për lëndën e Edukimit Fizik dhe profilin e përafërt me këtë lëndë.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, vlerësohet se nga ana e Zyrës Arsimore Devoll nuk janë respektuar procedurat e emërimit sipas Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” në lidhje me plotësimin me mësues të vendeve vakante në lëndën Edukim Fizik në shkollat “Banush Tarelli” Braçanj dhe në gjimnazin “Fuat Babani” Bilisht.

Në vlerësim të dokumenteve të administruara mbi procedurat e përdorura nga ZA Devoll për emërimet e punonjësve arsimorë, Komisioneri konstaton se janë në kundërshtim me legjislacionin e arsimit.

### **B. Shkaku i mbrojtur.**

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Zyrës Arsimore Devoll, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Pretendimi i MM se shkak për diskriminim ndaj saj është bërë bindja politike, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit 10221/2010. Nga shqyrtimi i dokumenteve nga Komisioneri, rezulton se MM është anëtare e subjektit politik “Partia Demokratike”, e vërtetuar nëpërmjet kartës së anëtarësisë datë 14.05.2014.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me shkakun e mbrojtur.**

Në lidhje me pretendimin e ankueses se është diskriminuar për shkak të bindjes politike, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një lidhje shkakësore mes trajtimit të pabarabartë dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, pasi referuar legjislacionit për emërimin e drejtuesve të njësive

arsimore vendore, vlerësohet se zgjedhja<sup>4</sup> e drejtuesve të njësisive arsimore vendore organizohet nga Departamenti i Administratës Publike bazuar në rezultatet e konkurimit të kandidatëve.

Nga ana e ankueses nuk u sollën prova për të vërtetuar se drejtuesi i zyrës arsimore apo mësueset e tjera të emëruara të kishin bindje politike të kundërta me ankuesen. Pra vlerësohet se nuk ka patur veprime, paragjykitime apo trajtim të pabarabartë për shkak të bindjes politike të ankueses nga ana e drejtuesit të Zyrës Arsimore Devoll.

Gjatë trajtimit të ankesë së M.M, u administruan prova se ka patur një situatë paligjshmërie nga ana e drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me respektimin e procedurave të emërimit të mësuesve, por nuk u siguruan prova apo informacion për të provuar se personat përgjegjës që kanë drejtuar procesin e emërimit të mësuesve kanë patur bindje politike të kundërta me subjektin ankues.

Bazuar në Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, Kreu 4, “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit”, pika 9, “Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit. ...”, specifikohet se është në tagrin e drejtuesit të institucionit të arsimit parauniversitar të bëjë emërimet në përputhje me parashikimet ligjore të përcaktuara në këtë udhëzim. Komisioneri vlerëson se drejtuesit e institucioneve arsimore janë në shkelje të emërimeve të mësipërme si dhe ZA Devoll ka qenë në dijeni të këtyre emërimeve, të cilat rezultojnë të paligjshme, pasi nuk janë respektuar procedurat e emërimit të mësuesve.

Në Kreun 5/1 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, përcaktohet se: “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të kandidatëve për mësues, për të tri fazat, drejtuesi i njësisë arsimore vendore krijon Komisionin e Vlerësimit”, ndërsa në pikën 5/g të këtij Kreu përcaktohet se: Komisioni është përgjegjës për: Monitorimin e punësimeve sipas renditjes së përgjithshme të kandidatëve dhe raportimin në MAS, çdo tre muaj”. Në referim të dispozitës së cituar, nga ana e drejtuesve të ZA Devoll, nuk u vendos në dispozicion të Komisionerit asnjë dokumentacion që të vërtetonte se ishte respektuar kjo procedurë për rastet e emërimit për punonjësit mësimorë, O.A dhe Xh.P.

Si rezultat, Komisioneri është i mendimit se ZA Devoll nuk ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm për mosrespektimin e emërimit të mësuesve sipas renditjes së portalit dhe arsyet se përse drejtuesit e ZA Devoll nuk mund të bënin emërimin e M.M në një nga pozicionet e mësuesit.

---

<sup>4</sup> Në nenin 30/5 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” shkruhet se: “Drejtuesi i njësisë arsimore vendore, përgjegjësit e sektoreve dhe specialistët e tyre përzgjidhen me konkurim të hapur, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.12.2009 “Statusi i nëpunësit civil”. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, drejtoritë arsimore rajonale, përfshihen për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil. Përfshirja e tyre është parashikuar në lidhjen nr.1 (numri rendor 88, të VKM nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të ndryshuar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, shtetasja MM është vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme e të parregullta të drejtuesve të Zyrës Arsimore Devoll, por nuk provohet lidhja shkakësore mes trajtimit të paligjshëm dhe bindjeve politike të ankueses.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasës M.M nga ana e Zyrës Arsimore Devoll, për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(shkaku: bindja politike)

(fusha: punesim)